

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
Slovakia Invest Sh.p.k**

- Z. Bekim Sabani, atësia Sejdi datëlindje 12.10.1991 qytetar i Sllovaki-së, me vendlindje Shkup, Maqedoni dhe banim në Cernysevskeho 23, 851 01 Bratislava, Slovakia

kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është Slovakia Invest Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është Tiranë, Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Aurora, Kati i 2

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Agjensisë ndërmjetësimi, marketingu, aktivitetit multimedial, zhvillimin e programeve televizive dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji.

Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Euro 8,000 (tetëmijë) i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Bekim Sabani, atësia Sejdi datëlindje 12.10.1991 qytetar i Sllovaki-së, me vendlindje Shkup, Maqedoni dhe banim në Cernysevskeho 23, 851 01 Bratislava, Slovakia të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Euro 8,000 (tetëmijë) që i korespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohen (2) Administratorë i Shoqërisë, të cilët mund të përfaqësojnë shoqërinë me të drejta të plotë edhe në mungesë të njëri tjetrit, personat e më poshtë:

- **Z. Bekim Sabani**, atësia Sejdi datëlindje 12.10.1991 qytetar i Sllovaki-së, me vendlindje Shkup, Maqedoni dhe banim në Cernysevskeho 23, 851 01 Bratislava, Slovakia, cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- **Z. Aldenis Cullhaj**, qytetar shqiptar, lindur më 21.09.1981 me pasaporte I15921162M, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU I VETEM

Bekim Sabani

Bekim Sabani

Data: 24.03.2021